



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. Prot. 2428/2

Datë 21.03.2019

URDHËR

Nr. 214, Datë 21.03.2019

**“PËR
PËRCAKTIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE PËR RIFRESKIMIN E DOSJES SË
PLOTË PERSONALE TË NOTERËVE DHE ASISTENT NOTERËVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” të ndryshuar, dhe të nenit 142, pika 12, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Noterët dhe asistentë noterët, kanë detyrimin ligjor të rifreskojnë dosjen e plotë personale të depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij Urdhri.
2. Dosja e plotë e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, dorëzohet duke filluar nga data 25.4.2019 deri në datën 25.5.2019, përmes shërbimit postar, në adresë të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Dosja e noterit, që duhet të dorëzohet sipas afatit të sipërcaktuar, duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm, të noterizuar:
 - a) 2 fotografi;
 - b) Kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
 - c) Kopjen e diplomës së Fakultetit të Drejtësisë dhe certifikatës së notave;
 - d) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar;
 - e) Formularin e vetëdeklarimit si noter, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Urdhri dhe pjesë përbërëse e tij;
 - f) Kopje të urdhrit të Ministrit për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit;
 - g) Vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Noterisë për periudhën kur noteri ka qënë asistent dhe emrin e noterit pranë të cilit ka qënë asistent;

- h) Vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë kur është regjistruar si anëtar i saj;
- i) Kopjen e librezës së punës (kur ka qenë punëmarrës);
- j) Kopjen e certifikatës së regjistrimit si person fizik;
- k) Kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor;
- l) Modelin e vulës dhe të nënshkrimit;
- m) Kopje të dokumenteve që pasqyrojnë masat disiplinore të dhëna (ose janë dhënë të tilla);
- n) Certifikatën e Dhomës Kombëtare të Noterisë (kur është dhënë e tillë);
- o) Kopje të dëshmisë që vërteton marrjen e gradës/titullit shkencor apo vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë nëse noteri ndjek studimet pranë shkollës doktores;
- p) Kopje të dëshmisë së mbrojtjes së gjuhëve të huaja;
- q) Deklarim nëse ka marrë në dorëzim arkivë noteriale të ish noterëve dhe të cilit prej tyre;
- r) Masa disiplinore (numri dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, si dhe koha kur ajo është ekzekutuar ose është parashkuar, duke bashkëlidhur kopje të Urdhrit);
- s) Kopje të vendimeve të gjykatave për rastet kur janë kundërshtuar masat disiplinore;
- t) Kopje të noterizuar së kontratës së lidhur me asistent noterin i cili është i atashuar pranë zyrës së tij noteriale.
- u) Kur është rasti, dokumente që pasqyrojnë transferime ose veprime të tjera (ndërprerje për shkak sëmundjeje ose shtatzënie, procesverbale për prishje vule etj.);

4. Dosja e asistent noterit, që duhet të dorëzohet sipas afatit të sipërcaktuar, duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm, të noterizuar:

- a) 2 fotografi;
- b) Kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
- c) Vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;
- d) Kopjen e diplomës së Fakultetit të Drejtësisë dhe të certifikatës së notave;
- e) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;
- f) Formularin e vetëdeklarimit si asistent noter, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij Urdhri dhe pjesë përbërëse e tij;
- g) Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;
- h) Kopjen e librezës së punës (kur ka qenë punëmarrës);
- i) Kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe noterit pranë të cilit do të qëndrojë/ka qëndruar si asistent;
- j) Kopjen e aktit të miratimit si asistent;
- g) Vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Noterisë për periudhën kur ka qenë asistent dhe emrin e noterit pranë të cilit ka qenë asistent;
- k) Referencën e lëshuar nga noteri, për periudhën e qëndrimit si asistent;
- l) Certifikatën e Dhomës Kombëtare të Noterisë (kur është dhënë e tillë);

- m) Masa disiplinore (numri dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, si dhe koha kur ajo është ekzekutuar ose është parashkruar, duke bashkëlidhur kopje të Urdhrit);
- n) Kopje të vendimeve të gjykatave për rastet kur janë kundërshtuar masat disiplinore;
- o) Kopje të dëshmisë që vërteton marrjen e gradës/titullit shkencor apo vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë nëse noteri ndjek studimet pranë shkollës doktorale;
- p) Kopje të dëshmisë së mbrojtjes së gjuhëve të huaja.
- q) Kur është rasti, njoftime të ndryshme nga noteri, dokumente që pasqyrojnë arsye të ndërprerjes e shtyrjes së periudhës së qëndrimit si asistent ose marrjen e masave disiplinore ndaj asistentit etj.

5. Formularët e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 1 dhe shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij Urdhri, duhet të plotësohen elektronikisht dhe të përcillen të nënshkruara përmes postës në adresë të Ministrisë së Drejtësisë. Formulari sipas Shtojcës nr. 1, duhet të vuloset me vulën personale të noterit.

6. Pasqyrimi i të dhënave të rreme në formularin e vetëdeklarimit, në momentin e konstatimit, përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor. Trajtimi i të dhënave të depozituara sipas këtij Urdhri, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kur Grupi i Punës në Ministrinë e Drejtësisë, i ngarkuar për kryerjen e verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga noterët dhe asistent noterët, vëren mangësi, i kërkon noterit/asistent noterit plotësimin e mangësive në dokumentacionin e dorëzuar brenda 10 ditëve pune.

8. Grupi i Punës në Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, kryen verifikimin e dokumentacionit të depozituar, në raport me të dhënat e administruara nga institucionet shtetërore përgjegjëse dhe të dhënat e administruara nga vetë Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe ato të dhëna të regjistruara nëpër regjistrat përkatës të noterëve dhe asistent noterëve.

9. Grupi i Punës kryen verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar brenda 60 ditëve nga administrimi i dosjes së noterit apo asistent noterit dhe i paraqet Ministrit të Drejtësisë raportin e vlerësimit për secilën dosje.

10. Në rastet kur konstatohen problematika gjatë administrimit dhe verifikimit të dokumentacionit, që mund të çojnë në heqjen e licencës, sipas nenit 21, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, struktura përgjegjëse informon Ministrin e Drejtësisë për marrjen e masave për ndjekjen e procedurës përkatëse ligjore.

11. Mosrespektimi i kërkesave të këtij Urdhri nga noteri përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. Dokumentacioni i administruar nga Ministria e Drejtësisë sipas këtij Urdhri, i cili pasqyron në mënyrë kronologjike të gjithë procesin e ndjekur nga asistent noteri dhe noteri në përputhje me legjislacionin në fuqi, numërohet dhe pasqyrohet në fletën e pasqyrës së dokumenteve të dosjes të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të saj ose të bashkëlidhur në kapak me vulën e Ministrisë së Drejtësisë dhe administrohen fizikisht në Sektorin e Arkiv Protokollit.
13. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
14. Ky Urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe i përcillet Dhomës Kombëtare të Noterisë, për bërjen e njoftimeve pranë noterëve dhe asistent noterëve të regjistruar, mbi detyrimin për rifreskimin e dosjeve dhe dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)



FORMULAR VETËDEKLARIMI
Për plotësimin me të dhëna të “Regjistrin të Noterëve”

Shtojca nr. 1

Të dhënat e noterit

Emri, Atësia, Mbiemri	
Gjeneralitete të mëparshme (Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe atë herë sa janë ndryshuar)	
Adresa e vendbanimit¹ (qyteti/fshati, rruga, numri i ndërtesës, hyrja, apartamenti)	
Nr. i licencës së ushtrimit të veprimtarisë noteriale²	
Data e fillimit të veprimtarisë noteriale³	
Adresa e ushtrimit të aktivitetit⁴ (qyteti, rruga, numri i ndërtesës, hyrja, apartamenti)	
Nr. i identifikimit tatimor⁵	
Diplomimi⁶ (viti i diplomimit, numri i diplomës, lloji i diplomës, referuar ligjit “Për arsimin e lartë”);	
Dhoma vendore e Noterisë ku jeni i anëtarësuar⁷ (Vërtetimi nga dhoma e noterisë në nivel vendor se është pranuar anëtar i kësaj dhome)	
Masa disiplinore⁸ (nr. dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, si dhe koha kur ajo është ekzekutuar ose është parashkruar)	
Ushtrimi i veprimtarisë si avokat⁹	

Keni ushtruar në ndonjë moment funksionin e administratorit pranë një shoqërie tregtare me seli dhe aktivitet në Republikën e Shqipërisë? (Nëse po, emri i shoqërisë tregtare dhe koha gjatë së cilës është ushtruar detyra)	
Keni ushtruar veprimtarinë në mësimdhënie?¹⁰ (Nëse po, Institucioni i Arsimit të Lartë, orët ditore/javore të angazhimit)	
Grada shkencore apo titulli shkencor i fituar¹¹ (Dëshmia që vërteton marrjen e gradës/titullit shkencor, informacion nëse jeni në proces doktrature)	
Jeni angazhuar në kryerjen e përkthimeve të gjuhëve të huaja?¹²	
Punësimi i asistent noterëve pranë zyrës noteriale¹³ (kontrata e lidhur me asistent noterin/noterët)	
A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Po/Jo) ¹⁴	
A është caktuar ndaj jush ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale? (Po/Jo) ¹⁵	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se të dhënat e plotësuara sa më sipër në lidhje me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit “Për plotësimin me të dhëna të “Regjistrimit të Noterëve” janë të sakta në zbatim të urdhrave të ministrit të Drejtësisë me nr. _____, datë _____ “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve” dhe po i dërgoj sot në datën _____, nëpërmjet postës në adresën e Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi Zogu i I-rë. Autorizoj Ministrinë e Drejtësisë për verifikimin e vërtetësisë së tyre, me institucionet përkatëse shtetërore.

DEKLARUESI – NOTER

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

Shënim: Aktet dokumentare që do vërtetojnë plotësimin e të dhënave të vetëdeklaruar në këtë formular, do të dorëzohen shkresërisht në adresë të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, shoqëruar me dokumentacionin vërtetues si vijon:

1. Për adresën e vendbanimit: Një dokument që vërteton vendbanimin aktual, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10/129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar, marrë nga zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, jo më larg se 30 ditët e fundit, nga njoftimi i vetëdeklarimit.
2. Për numrin e licencës: Një kopje të vulosur me vulën e noterit të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e licencës.
3. Për datën e fillimit të veprimtarisë noteriale: Kërkesa/shkresa zyrtare për fillimin e veprimtarisë noteriale bërë nga noteri si dhe procesverbali i pajisjes me vulë të njomë dhe të thatë.
4. Për adresën e ushtrimit të aktivitetit: Urdhër i Ministrit të Drejtësisë për dhënien e licencës dhe përcaktimin e njësisë territoriale për ushtrimin e veprimtarisë noteriale si dhe një dokument që vërteton lidhjen e adresës së godinës, njësisë, ndërtesës, hyrjes, apartamentit sipas të dhënave aktuale të zyrës së gjendjes civile në bashkinë/komunën që ka në juridiksion territorial objektin e deklaruar, me ushtrimin e veprimtarisë noteriale jo më larg se 30 ditët e fundit (dokument të pronësisë së noterit për ambientin zyrë që përdor ose kontratë të qerasë me pronarin e objektit për përdorimin e ambientit nga noteri).
5. Për numrin e identifikimit tatimor të noterit (person fizik): Një ekstrakt historik (dita e vetëdeklarimit) nxjerrë elektronikisht nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).
6. Për diplomimin: kopje të noterizuar të diplomave përkatëse të lëshuara nga Institucioni i Arsimit të Lartë.
7. Për Dhomën vendore të Noterisë ku është i anëtarësuar: Vërtetimi nga dhoma e noterisë në nivel vendor se është pranuar anëtar i kësaj dhome.
8. Për dhënien e masës disiplinore: nr. dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës.
9. Për ushtrimin e veprimtarisë si avokat dhe periudhën përkatëse: Një kopje të certifikatës përmes së cilës është fituar titulli si avokat si dhe vërtetim për periudhën kur është ushtruar ky profesion, shoqëruar me vërtetime nga organet tatimore dhe sigurimet shoqërore, që vërtetojnë ushtrimin efektiv të profesionit.
10. Për ushtrimin e veprimtarisë së mësimdhënies: Një vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë pranë të cilit është i punësuar si lektor/ asistent lektor duke u përcaktuar dhe orët ditore/mujore të angazhimit.
11. Për gradat dhe titujt shkencorë të zotëruar: Dokumentin që vërteton gradën/titullin shkencor të fituar. Nëse noteri ndjek studimet e doktoraturës, një vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë pranë të cilit është në proces doktorat.
12. Për kryerjen e përkthimeve: Dëshmi të mbrojtur të gjuhës që zotëron si dhe nëse është përkthyes i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë.
13. Për punësimin e asistent noterit: Një kopje të kontratës së lidhur me asistent noterin si dhe një dokument identifikimi të tij.
14. Nëse po, specifikoni Gjykatën, Numrin dhe datën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, masën e dënimit me burgim, veprën penale për të cilën jeni dënuar, nenin dhe llojin, duke bashkëlidhur kopje të vendimit.
15. Nëse po, specifikoni llojin e masës shtrënguese të sigurisë, dhe nëse është aktualisht në fuqi apo e revokuar.

FORMULAR VETEDEKLARIMI
Për plotësimin me të dhëna të “Regjistrin të Asistent Noterëve”

Shtojca nr. 2

Të dhënat e Asistent Noterit

Emri, Atësia, Mbiemri	
Gjeneralitete të mëparshme (Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe atë herë sa janë ndryshuar)	
Adresa e vendbanimit¹ (qyteti/fshati, rruga, numri i ndërtesës, hyrja, apartamenti)	
Diplomimi² (viti i diplomimit, numri i diplomës, lloji i diplomës, referuar ligjit “Për arsimin e lartë”);	
Data e emërimit si asistent noter³	
Dhoma e noterisë dhe noteri pranë të cilit qëndron si asistent⁴ (dhoma e noterisë në nivel lokal, anëtar i së cilës është noteri pranë të cilit qëndron si asistent, si dhe emri dhe mbiemri i noterit pranë të cilit qëndron/ka qëndruar si asistent)	
Periudha si asistent⁵ (data e fillimit, mbarimit, dhe zgjatja ose ndërprerja e afatit si asistent)	
Masa disiplinore⁶ (nr. dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, si dhe koha kur ajo është ekzekutuar ose është parashkruar)	
Ushtrimi i veprimtarisë si avokat?⁷	
Keni ushtruar në ndonjë moment funksionin e administratorit pranë një shoqërie tregtare me seli dhe	

aktivitet në Republikën e Shqipërisë? (Nëse po, emri i shoqërisë tregtare dhe koha gjatë së cilës është ushtruar detyra)	
Keni ushtruar veprimtarinë në mësimdhënie?⁸ (Nëse po, Institucioni i Arsimit të Lartë, orët ditore/javore të angazhimit)	
Grada shkencore apo titulli shkencor i fituar?⁹ (Dëshmia që vërteton marrjen e gradës/titullit shkencor, informacion nëse jeni në proces doktrature)	
Jeni angazhuar në kryerjen e përkthimeve të gjuhëve të huaja?¹⁰	
A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Po/Jo) ¹¹	
A është caktuar ndaj jush ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Po/Jo) ¹²	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se të dhënat e plotësuara sa më sipër në lidhje me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit “Për plotësimin me të dhëna të “Regjistrat të Asistent Noterëve” janë të sakta në zbatim të urdhrat të ministrit të Drejtësisë me nr._____, datë _____ “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve” dhe po i dërgoj sot në datën _____, nëpërmjet postës në adresën e Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi Zogu i I-rë. Autorizoj Ministrinë e Drejtësisë për verifikimin e vërtetësisë së tyre, me institucionet përkatëse shtetërore.

DEKLARUESI – ASISTENT NOTER

(emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Aktet dokumentare që do vërtetojnë plotësimin e të dhënave të vetëdeklaruar në këtë formular, do të dorëzohen shkresërisht në adresë të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, shoqëruar me dokumentacionin vërtetues si vijon:

1. Për adresën e vendbanimit: Një dokument që vërteton vendbanimin aktual, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, marrë nga zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, jo më larg se 30 ditët e fundit, nga njoftimi i vetëdeklarimit.
2. Për diplomimin: kopje të noterizuar të diplomave përkatëse të lëshuara nga Institucioni i Arsimit të Lartë
3. Për emërimin si asistent noter: Kopje të noterizuar të kontratës së lidhur me noterin për emërimin si asistent noter; kopje të konfirmimit nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterisë; shoqëruar me vërtetim nga

- sigurimet shoqërore dhe tatimet për pagesën e kontributeve shoqërore dhe detyrimeve tatimore për periudhën e stazhit të detyrueshëm 2 vjeçar.
4. Për Dhomën e Noterisë dhe Noterin pranë së cilit qëndron si asistent noter: Vërtetim nga Dhoma e Noterisë përkatëse si dhe kontrata e lidhur me noterin dhe të dhënat rreth tij.
 5. Për periudhën si asistent: Kopje të noterizuar të kontratës së lidhur me noterin për emërimin si asistent noter si dhe certifikatë e lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë në rastet kur noteri ka përfunduar periudhën 2 vjeçare të emërimit si asistent pranë një noteri.
 6. Për masën disiplinore: nr. dhe data e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës.
 7. Për ushtrimin e veprimtarisë si avokat dhe periudhën përkatëse: Një kopje të certifikatës përmes së cilës është fituar titulli si avokat si dhe vërtetim për periudhën kur është ushtruar ky profesion, shoqëruar me vërtetime nga organet tatimore dhe sigurimet shoqërore, që vërtetojnë ushtrimin efektiv të profesionit.
 8. Për ushtrimin e veprimtarisë së mësimdhënies: Një vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë pranë të cilit është i punësuar si lektor/ asistent lektor duke u përcaktuar dhe orët ditore/mujore të angazhimit.
 9. Për gradat dhe titujt shkencorë të zotëruar: Dokumentin që vërteton gradën/titullin shkencor të fituar. Nëse noteri ndjek studimet e doktoraturës, një vërtetim nga Institucioni i Arsimit të Lartë pranë të cilit është në proces doktorat.
 10. Për kryerjen e përkthimeve: Dëshmi të mbrojtur të gjuhës që zotëron si dhe nëse është përkthyes i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, vërtetim nga institucioni.
 11. Nëse po, specifikoni Gjykatën, Numrin dhe datën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, masën e dënimit me burgim, veprën penale për të cilën jeni dënuar, nenin dhe llojin, duke bashkëlidhur kopje të vendimit.
 12. Nëse po, specifikoni llojin e masës shtrënguese të sigurisë, dhe nëse është aktualisht në fuqi apo e revokuar.